



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI RREGULLATOR**

Data: 13.2.2025

Nr: 8

Ora: 14:00

**VENDIM**

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 11, DATË 1.11.2024, TË**  
**KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË**  
**DOKUMENTACIONIT QË KËRKOHEP PËR TË VËRTETUAR QËNDRIMIN E**  
**ZGJEDHËSIT SHQIPTAR QË VOTON JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË, ME QËLLIM REGJISTRIMIN NË LISTËN E ZGJEDHËSVE JASHTË**  
**VENDIT”**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, dhe nenit 25, pika 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**V E N D O S I:**

I. Në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”, bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 1, shkronjës “h”, të Kreut II, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Dokumenti i cili provon adresën e qendrimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ngarkohet në PER nga çdo anëtar i familjes së personit në emër të të cilit rezulton të jetë dokumenti i adresës. Në këtë rast personi që përdor adresën e anëtarit të familjes së tij, ngarkon në PER një nga dokumentet që vërtetojnë lidhjen familjare me mbajtësin e adresës, si vijon:

Data: 13.2.2025 Nr: 8

Ora: 14:00



“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”

- a) certifikatë familjare të personit që aplikon në PER, e cila tregon lidhjen me personin në emër të të cilit është dokumenti i adresës;
- b) certifikatë personale e personit që aplikon në PER, e cila tregon lidhjen me personin në emër të të cilit është dokumenti i adresës;
- c) çdo certifikatë tjetër që tregon lidhjen me mbajtësin e adresës;
- ç) një deklaratë të nënshkruar nga personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës. Teksti i deklaratës miratohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendoset në PER si tekst i detyrueshëm të cilit duhet t'i përmbahet deklaruesi. Teksti i deklaratës shkruhet nga deklaruesi në një fletë të bardhë, nënshkruhet prej tij dhe ngarkohet së bashku me dokumentin e identifikimit në PER.”.

2. Pas pikës 1/1 të shtuar, shtohet pika 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/2. Dokumenti i adresës në emër të një personi mund të ngarkohet në PER edhe nga persona të tjerë të cilët banojnë në të njëjtën adresë me personin në emër të të cilit është ky dokument. Në këtë rast personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës duhet të lëshojë një deklaratë sipas së cilës deklararon se aplikuesi është banues në të njëjtën adresë me të. Teksti i deklaratës miratohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendoset në PER si tekst i detyrueshëm të cilit duhet t'i përmbahet deklaruesi. Teksti i deklaratës shkruhet nga deklaruesi në një fletë të bardhë dhe nënshkruhet prej tij. Në të njëjtën fletë vendoset edhe dokumenti i identifikimit i deklaruesit dhe ngarkohet në PER si një dokument i vetëm.”.

- II. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- IV. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Ilirjana NANO      Kryetar**

**Arens ÇELA      Anëtar**

**Dritan ÇAKA      Anëtar**

**Helga VUKAJ      Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ Anëtar**

Data: 13.2.2025 Nr: 8

Ora: 14:00



“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”